



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në bazë të Ligjit nr.03/L-212 të Punës neni 8 dhe neni 10 paragrafi 2 nëparagrafi 2.2, neni 22 paragrafi 4 i Statutit të Trepça Sh.A., neni 8 paragrafi 2 të Rregullores për Marrëdhënie pune në Trepça Sh.A., si dhe bazuar në Rregulloren nr. 2778 të datës 26.05.2023 për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Njësinë Biznesore Minierat me Flotacion Trepça Stantërg, Trepça Sh.A me datë 08.06.2026 publikon këtë:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Titulli i pozitës së punës:	Agjustator
Koeficienti/Paga:	650€ bruto
Nr. i kërkuar:	2
Kohëzgjatja e emërimit:	Në periudhë të caktuar (1 vjeçare me mundësi vazhdimi, puna provuese 6 muaj)
Data e njoftimit:	08.06.2026
Afati për aplikim:	09.06.2026 – 23.06.2026
Institucioni:	Ndërmarrja "Trepça Sh.A."
Njësia Biznesore:	Miniera me Flotacion Trepça – Stan Tërg
Vendi i punës:	Stan Tërg

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Kryen detyrat dhe punët e mirëmbajtjes makinerike në repart;
- Menjanojnë prishjet dhe mangësit në repart në kuadër të aftësive të veta;
- Ka për detyrë që me ndërgjegje dhe profesionalisht ti mënjanojë prishjet dhe mangësit në pajisje si dhe t'i zbatoj urdhërat e udhëheqësit;
- Obligohet që ti përdorë mjetet mbrojtëse në punë;
- I përgjigjet brigadierit dhe kryepunëtorit të mirëmbajtjes makinerike;
- Kryen edhe të gjitha punët tjera me urdhër të udhëheqësit;

2. Kriteret e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me ligj.

3. Kriteret e veçanta

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme;
- Duhet të ketë së paku 2 vite përvojë pune.

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit

- Aplikacioni (i cili shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Deklarata nën betim (e cila shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Dëshminë e përvojës së punës profesionale;
- Dëshmi nga gjykata kompetente që dëshmon se aplikuesi nuk është i dënuar për

vepër penale apo nuk është nën hetime jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;

- CV-Biografia;
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Kopjet e diplomave të noterizuara mbi kualifikimin arsimor dhe / ose nostrifikimin për diplomat jashtë vendit.

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- a. Testimi me shkrim- 100 pikë
- b. Intervista – 300 pikë

6. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.” në linkun <https://trepcasha.com/> , tek kategoria Shpallje.

7. Mënyra e aplikimit


- Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zyrën e protokollit të Trepça Sh.A., në Menaxhmentin e Trepça Sh.A.- Parku Industrial Mitrovicë, çdo ditë pune nga ora 08:00- 16:00.

8. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.”

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Trepça Sh.A.
Kryesheti Ekzekutiv



Faton Ahmeti

